

## AKT THMELIMI

### i shoqërisë tregtare “PASTRIM KIMIK SOLID” sh.p.k

Sot me date 01.07.2023, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, " Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortakët :

- Z. Diart NEZA, i datëlindjes 20.05.1993, lindur në B.Curri ALB, banues në Kamëz Rruga: "Berisha", banesa 35, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar.
- Z. Besart MATA, i datëlindjes 28.04.1992, lindur në Novosej ALB, banues në Kamëz Rruga: "Amsterdami", banesa 7, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar.
- Z. Afrim PREKPERAJ, i datëlindjes 05.06.1991, lindur në Curraj ALB, banues në Kamëz Rruga: "Jon", banesa 16, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar.

Bashkëthemeluesit zotërojnë: Afrim prekperaj 33.34 %, ndërsa, dy ortakë e tjerë nga 33.33 %, të kapitalit dhe krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“PASTRIM KIMIK SOLID”** sh.p.k., me akt themelimi si vijon :

#### Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **“PASTRIM KIMIK SOLID”** sh.p.k., shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

#### Selia e Shoqërisë

#### Neni 2

Selia e shoqërisë **“PASTRIM KIMIK SOLID”** sh.p.k., do të ketë selinë në rrugën "Bulevardi Nene Tereza", Ndertesa nr.195, Nr. Pasurie 139/7/N16-6, Zona Kadastrale 2066, Kamëz.

Shoqërija mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filial si Brenda ashu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve themelues.

#### Objektivi i Veprimitarise

#### Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat:

Pastrim Kimik , Lavanteri ;

## **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

### **Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pakufizuar. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohe dhe përfshirë çfarðo lloj shkaku .

## **Kapitali i Shoqërisë**

### **Neni 5**

Kapitali fillestare i shoqërisë private “**PASTRIM KIMIK SOLID**” sh.p.k do të jetë 100 000 (njëqind mijë lekë ). Kapitali është 100% nga kuotat e ortakëve bashkëthemelues, i ndarë në 3kuota. Kapitali themeltar fillestare mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestare).

## **Drejtimi i Shoqërisë**

### **Neni 6**

Shoqëria dëtihet nga administrator i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Administratori është përfaqësuesi i shoqërisë në marradhanie me të tretë dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme .

### **Neni 7**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve bashkëthemelues të shoqërisë.

### **Neni 8**

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë edhe administrator të tjerë të vlerave materiale. Kanë të drejtë të caktojnë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortak.

### **Neni 9**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë .

### **Neni 10**

Shoqëria ka vulen e saj me madhësi të zakonshme, me logo dhe tekstin rrëth saj .

### **Neni 11**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare, të vendit, si dhe rregullave që zbatohen përbiznesin që kryen kjo shoqëri.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë akt-themelimi, rregullohen sipas statutit të shoqërisë, si dhe sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës shqiptar.

**Neni 12**

Akti i themelimit u përpilua në 4 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **“PASTRIM KIMIK SOLID” sh.p.k**

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët:

**Ortakët themelues të “PASTRIM KIMIK SOLID” sh.p.k.;**

Diart Neza

DIART NEZA  


Besart Mata

Besart Mata  


Afrim Prekperaj

Afrim Prekperaj  
